1					
2					
3					
4					
5					
6					

- shto/fshi rreshta të tjerë nëse nevojitet.

Ne autorizojmë autoritetin kontraktor të verifikojë informacionin e dhëne në këtë tabelë.

PERSONI I KONTAKTIT (për këtë ofertë)

Emri:

Adresa:

Nr. Telefonit:

Faks:

E-mail:

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 11

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik)

DEKLARATË MBI KONTRATAT E LIDHURA DHE/ OSE NE PROCES⁴

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____ me cilësinë _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj se kam në proces dhe/ose jam shpallur fitues për kontratat e mëposhtme:

Nr.	Autoriteti kontraktor	Objekti i procedurës se prokurimi/kontratës	Vlera e shpallur fituese

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Përfaqësuesi i ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shënim: Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të bashkimit duhet të plotësojë këtë deklaratë.

⁴ Kjo deklarate ka si qëllim plotësimin e kriterit ligjor që operatori ekonomik brenda së njëjtës periudhë nuk është kontraktor/nënkontraktor për kontratë/kontrata të lidhura dhe/ose është shpallur fitues, me vlerë të përbashkët ose të veçantë, më të madhe se 100 % i kufirit maksimal, që disponon, sipas licencës profesionale, të lëshuar nga autoriteti kompetent

Shtojca 12

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr. 8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) Nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- c) Nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- ç) Nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) Ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura mësipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.

Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si mësipër.

Veç kësaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:

a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomik është krijuar zyrtarisht;

b. Prokura e posaçme.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Përshkrimin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;*
- b. *Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur, sipas Shtojcës 1/1;*
- c. *Sigurim oferte, (nëse është e zbatueshme) sipas Shtojcës 3;*
- ç. *Deklaratë mbi përmbushjen e Specifikimeve Teknike, sipas Shtojcës 5;*
- d. *Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;*
- dh. *Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës Shtojcës 8/1;*
- e. *Formular vlerësimi sipas Shtojcës 9;*
- f. *Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve/makinerive sipas Shtojcës 10;*
- g. *Deklarate mbi kontratat e lidhura apo ne proces, sipas Shtojcës 11;*
- gj. *Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 PËR KAPACITETIN LIGJOR/PROFESIONAL I OPERATORËVE EKONOMIK:

➤ **Sipas Kritereve të Përgjithshme të Pranimi/Kualifikimit, Shtojca 12, Pika 1.**

Nëse oferta dorëzohet nga një Bashkim Operatorësh Ekonomik, duhet të dorëzohen:

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

2.2 PËR KAPACITETIN EKONOMIK DHE FINANCIAR:

- a) Xhiro mesatare e realizuar nga Operatori Ekonomik gjatë tre viteve të fundit (2017, 2018 dhe 2019) duhet të mos jetë më e vogël se 50% e vlerës se objektit që tenderohet. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti Operatori Ekonomik duhet të paraqes një vërtetim nga Administrata Tatimore për xhiron vjetore të realizuar në 3 (Tre) vitet e sipërpërmendura.
- b) Operatori Ekonomik duhet të ketë një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm (të mos ketë dalë me humbje/rezultat negativ) gjatë viteve 2017, 2018 dhe 2019. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti Operatori Ekonomik duhet të paraqes kopje të bilanceve të këtyre tre viteve, të paraqitura e konfirmuara nga Administrata Tatimore (*firmosur dhe vulosur në çdo faqe*) të shoqëruara nga akt ekspertiza të kryer nga Eksperti Kontabel i Autorizuar.
- c) Operatori Ekonomik duhet të paraqes një deklaratë me shkrim nga Administratori se subjekti ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet ku Operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitet për periudhën 2018, 2019 dhe 2020 sipas afateve të përcaktuara në ligjin Nr. 9632/2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar. Kësaj deklarate duhet ti bashkëngjiten të gjitha vërtetimet që dëshmojnë se operatori ekonomik ka paguar detyrimet përkatëse, në vendet ku ka ushtruar apo ushtron aktivitet për periudhën e sipërcituar.

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vërtetësinë e informacionit të paraqitur. Në rast deklarimi të rrem do të vepronet në përputhje me Nenin 13, Pika 3, Gërma "a" e Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar.

2.3 PËR KAPACITETIN TEKNIK:

2.3.1 Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

- a) Punë e ngjashme e realizuar në një kontrate të vetme me vlerë sa 50% e vlerës së fondit limit **(18,750,000) lekë**, të realizuar gjatë tre viteve të fundit, ku zërat e punimeve respektive plotësojnë kriteret minimale të preventivit të objektit në prokurim.

Ose

- b) Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e kontratave të punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit është në një vlerë sa dyfishi i vlerës së fondit limit **(75,000,000) lekë** dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, ku zërat e punimeve respektive plotësojnë kriteret minimale të preventivit të objektit në prokurim.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

2.3.1/a Për kontrata të realizuara me autoritete publike, operatori ekonomik duhet të paraqes dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Formularin e vlerësimit;
2. Kontratën/Kontratata;
3. Situacionin përfundimtar;
4. Aktin e kolaudimit;
5. Çertifikatën/Çertifikatat e marrjes në dorëzim;
6. Faturat tatimore përkatëse për çdo situacion të miratuara nga investitori.

Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh duhet të paraqitet si mëposhtë vijon:

- Kontrata e Bashkimit të Operatorëve deklaruar në fazën e tenderimit;
- Prokura e Posaçme e Bashkimit të Operatorëve deklaruar në fazë tenderimi;

Në rast se kontrata e paraqitur është realizuar si Nënkontraktor duhet të paraqitet si mëposht vijon:

- Kontrata bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor;
- Miratimi zyrtar si Nënkontraktor nga ana e Autoritetit Kontraktor;

2.3.1/b Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqes dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Formularin e vlerësimit;

2. Kontratë/Kontratat;
3. Leja e ndërtimit;
4. Situacionin përfundimtar;
5. Akt kolaudimi objekti;
6. Çertifikatën e marrjes në dorëzim të objektit;

Fatura tatimore për çdo situacion punimesh të jenë të miratuara nga Investitori.

Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

2.3.2 Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë se disponojnë liçense profesionale për zbatim punimesh në ndërtim si dhe në liçence disponojnë kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin liçencën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale tëzbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar.

Licenca e shoqërisë e vlefshme për kategoritë e mëposhtme:

- NP -1 ; NP -4; NP-12 ; NS -18 ;

sipas modelit të lëshuar nga MPPT/MTI/MEI apo Ministria kompetente e linjës;

Shoqëritë e huaja duhet të kenë kryer ekuivalentimin (Njehsimin) e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, Republika e Shqipërisë, në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale tëzbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar.

2.3.3 Për të provuar se ka përvojën e duhur, Operatori duhet të dëshmojë se ka të punësuar mesatarisht të paktën 40 (dyzet) punonjës, për periudhën (Qershor 2020 - Nëntor 2020) të dëshmuar me;

- a) Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën (Qershor 2020 – Nëntor 2020) .
- b) List pagesat e punonjësve të plotësuar rregullisht sipas formatit të përcaktimeve që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për secilin nga muajt në periudhën (Qershor 2020 - Nëntor

2020) dhe formularët e deklaramit të pagesave për sigurimet shoqërore, shëndetësore e TAP, me vulë banke.

2.3.4 Operatori duhet të dëshmojë se ka pjesë të stafit teknik që do të angazhohet për realizimin e punimeve stafin e mëposhtëm:

a. Stafi Teknik i Shoqërisë të ketë në përbërje :

1) Inxhinier Ndërtimi	1 (një)
2) Inxhinier Topograf	1 (një)
3) Inxhinier Gjeolog	1 (një)
4) Inxhinier Mjedisi	1 (një)
5) Inxhinier Gjeoteknik	1 (nje)

Secili prej pjestarëve të stafit teknik të mësipërm, duhet jetë në **Listëpagesat e shoqërisë për periudhën (Qershor 2020 - Nëntor 2020)** dhe në **licensën e shoqërisë**.

Për secilin prej pjesëtareve të stafit duhet të paraqitet:

- **Kontratë noteriale pune e vlefshme;**
- **Diploma;**

b. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, Urdhër mjeku, Diplomë, dhe të figurojë në listëpagesa në periudhën e kërkuar mësipër, 1 (një) mjek të përgjithshëm.

c. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar dhe të regjistruar sipas listëpagesave të shoqërisë duke filluar nga muaji Qershor 2020 minimalisht: Inxhinier Ndërtimi, Profili Infrastruktura e Transportit dhe Arkitekt Peizazhi, të shoqëruar për secilin punonjës me diplomë, kontratë noteriale pune dhe CV.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, secili prej operatorëve që plotëson kriteret e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.742 datë 06.11.2013, duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) mjek të përgjithshëm. *(Marrja në punë e mjekut të ndërmarrjes është e detyrueshme për ato ndërmarrje, ku numri i të punësuarve është jo më pak se 15 punonjës).*

d. Operatori ekonomik duhet të ketë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën **(Qershor 2020 - Nëntor 2020)** si pjesë e stafit teknik:

- Drejtuesi i punimeve në kantier që do të vendoset një Inxhinier që përmbush kriteret për të qenë koordinator për realizimin e punimeve në fushën e sigurisë dhe të shëndetit gjatë realizimit të punimeve, i cili duhet të jetë i pajisur me çertifikatë/dëshmi trajnimi (specialist për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë) që tregon pjesëmarrjen e tij në kurse specifike për sigurinë, të organizuara nga subjekte të njohura publike ose private, sipas kërkesave të ligjit Nr. 10237 datë 18.02.2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.

312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier".

Për specialistin e kërkuar si mësipër, duhet të paraqitet:

- ✓ Çertifikata e trajnimit për sigurinë dhe shëndetin në punë e dhënë nga një organizëm i akredituar, licencuar/certifikuar, certifikimi shqiptar ose i huaj;
- ✓ Specialist/ekspert zjarrëfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin, dëshmuar me kontratë pune dhe certifikata përkatëse e dhënë nga Drejtoria MZSH.

e. Të ketë në stafin e punonjësve jo me pak se 15 (pesëmbëdhjetë) punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente të akredituara sipas legjislacionit në fuqi si dhe dëshmi të kualifikimit profesional ku nga këta të jenë të paktën:

- Teknik ndërtimi/topograf - 2 (dy) punonjës (të pajisur me deftesë të shkollës mesme);
- Manovratorë mjetesh të rënda - 4 (katër) punonjës, pajisur me dëshmi aftësie profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda të ndërtimit dhe punimeve në tokë;
- Shofer - 4 (katër) punonjës, të pajisur me leje drejtimi;
- Mekanik – 2 (dy) punonjës;
- Specialist ndërtimi – 3 (tre) punonjës;

(Për punonjësit e sipërpërmendur të paraqiten dëshmitë përkatëse të kualifikimit profesional sipas kërkesave të mësipërme, dëshmitë e kualifikimit të sigurimit teknik për secilin prej tyre, dëshmi trajnimi nga IQT ose nga subjekte të tjera të licensuara për këto trajnime, kontratat e punës të vlefshme dhe të figurojnë në listëpagesat për periudhën (Qershor 2020 deri në Nëntor 2020).

f. Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë të administratorit të shoqërisë Drejtuesin/Drejtesit teknik të punimeve në objekt që do të jetë/jenë i/të pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt i paangazhuar në kontrata të tjera, i pajisur me diplomë dhe kontratë pune.

Operatori Ekonomik duhet të deklarojë me shkrim se Inxhinierët dhe punonjësit e kërkuar janë të paangazhuar në kontrata të tjera me Autoritetin Kontraktor.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me licensat e lëshuara nga QKB si mëposhtë:

- Licensa për mbrojtjen nga zjarri, Kodi 1.2 A;
- Licencë për veprimtarinë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis, Kodi III.2.A (1+2);

- Licencë për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve të ndryshme, Kodi III.2.B;

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të disponoj kontratë bashkëpunimi me një laborator të akredituar në fushën e testimeve të materialeve të ndërtimit në përputhje me S SH ISO/IEC 17025:2006 e vërtetuar kjo me certifikatat e akreditimit nga organizma akreditues, konkretisht në testet e mëposhtme:

- Përcaktimi i forcës në shtypje e mostrave të testimit;
- Provat pa shkatërrimin e mostrës, përcaktimi i numrit të tërheqies;
- Metodika e kryerjes së provave pa shkatërrim të betonit;
- Përcaktimi i shpejtësisë së impulsit ultrasonik;
- Përcaktimi i karakteristikave të boshllëqeve të mostrave bituminoze;
- Përcaktimi i trashësisë së një shtrese bituminoze;
- Matja e temperaturës;
- Përcaktimi i modulit të deformimit pjastër statike;
- Përcaktimi i modulit të deformimit pjastër dinamike;
- Metodika e kryerjes së provave pa shkatërrim të shtresave rrugore;
- Metoda e testimit për përcaktimin e deformimeve;
- Karakteristikat e sipërfaqes së rrugës;
- Matja e profilit tërthor dhe gjatësor të ashpërsisë dhe devijimet në drejtimet e valëzimeve gjatësore;
- Llogaritja e indeksit ndërkombëtar të rrjedhshmërisë së rrugës;

2.3.7 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i Çertifikuar sipas standardeve ISO të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht:

- **ISO 9001- 2015** (*Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë*) ose ekuivalente (e vlefshme);
- **ISO 14001- 2015** (*Sistemi i Menaxhimit Mjedisor*) ose ekuivalente (e vlefshme);
- **OHSAS 18001- 2007/2013** ose **ISO 45001-2018** (*Sistemi i Menaxhimit dhe Sigurisë në Punë*) ose ekuivalente (e vlefshme);
- **ISO 39001-2012** (*Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë së Trafikut Rrugor*) ose ekuivalente (e vlefshme);
- **ISO PAS 99:2012** (*Për sistemin e integruar të menaxhimit*) ose ekuivalente (e vlefshme);
- **ISO 3834-2:2006** (*Kërkesat e cilësisë për saldim me shkrirje të materialeve metalike*) ose ekuivalente (e vlefshme);
- **ISO 50001: 2011** (*Për sistemin e menaxhimit të energjisë*) ose ekuivalente (e vlefshme);

Dokumenta Standarde të Tenderit

- **ISO/IEC 27001:2013** (*Ndërtime civile dhe industrial, shtrim rrugesh dhe infrastrukturë rrugore e plotë ndërtim te ujësjellësa-kanalizime, sisteme ujitëse dhe kullimi, prodhim të materialeve inerte, prodhim betoni, asfalti, trajtime në lidhje me teknologjinë e informacionit*);
- **SA 8000:2014** (*Për Sistemin e menaxhimit të përgjegjesisë shoqërore*).

Të gjitha certifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

(Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë përkatësiht Çertifikatën ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas Akt - Marrëveshjes).

2.3.8 Operatori Ekonomik duhet të disponoj mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqes dëshmi për mjetet dhe paisjet teknike që ka në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik.

NR.	EMRI I MJETIT	NJËSI	SASI	STATUSI
1.	Kamion vetëshkarkues min 20 Ton	Copë	4	Në pronësi ose me qera
2.	Kamionçinë	Copë	2	Në pronësi ose me qera
3.	Autobot Uji	Copë	2	Në pronësi ose me qera
4.	Autobot Naftë	Copë	1	Në pronësi ose me qera
5.	GPS	Copë	1	Në pronësi ose me qera
6.	Instrument Gjeodezik (Total Station)	Copë	1	Në pronësi ose me qera
7.	Nivele dixhitale të saktësisë së lartë	Copë	1	Në pronësi ose me qera
8.	Pompa Uji	Copë	1	Në pronësi ose me qera
9.	Fadrom me goma	Copë	2	Në pronësi ose me qera
10.	Mini fadrom (Bobcat)	Copë	1	Në pronësi ose me qera
11.	Eskavator me goma	Copë	1	Në pronësi ose me qera
12.	Sharre per prerje asfalti	Copë	1	Në pronësi ose me qera
13.	Kompresor ajri	Copë	1	Në pronësi ose me qera
14.	Kompaktor ngjeshës	Copë	2	Në pronësi ose me qera
15.	Autobitumatrice	Copë	1	Në pronësi ose me qera
16.	Greider	Copë	1	Në pronësi ose me qera
17.	Rrul ngjeshës me peshë operative jo më pak se 18 Ton	Copë	2	Në pronësi ose me qera
18.	Rrul vibrues hekur-hekur mbi 9 Ton	Copë	1	Në pronësi ose me qera
19.	Rrul vibrues hekur- hekur asfalti mbi 4 Ton	Copë	1	Në pronësi ose me qera
20.	Rrul vibrues hekur- gome asfalti mbi 8 ton	Copë	1	Në pronësi ose me qera
21.	Frezë asfalti	Copë	1	Në pronësi ose me qera

Dokumenta Standarde të Tenderit

22.	Asfalto shtruese	Copë	1	Në pronësi ose me qera
23.	Makineri për matjen IRI&FËD	Copë	1	Në pronësi ose me qera
24.	Nyje inerte e pajisur leje mjedisore	Copë	1	Në pronësi ose me qera ose kontrate furnizimi
25.	Fabrike asfalti e pajisur me leje mjedisore	Copë	1	Në pronësi ose me qera ose kontrate furnizimi

2.3.9 Të paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si mëposhtë vijon:

- Kokore minimumi 30 (tridhjetë) copë;
 - Jelekë minimumi 30 (tridhjetë) copë;
 - Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 5 (pesë) copë;
 - Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 5 (pesë) copë;
 - Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 20 (njëzet) copë;
 - Kontenier për mbajtje malli 1 (një) copë;
- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vertetojnë pronësinë e mjetit:
 - Çertifikatën e pronësisë;
 - Lejen e qarkullimit;
 - Çertifikatën e kontrollit teknik;
 - Siguracionin;
 - Leje e transportit;

Ndërsa për mjetet e marra me qira krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë e cila duhet të përfshijë objektin përkatës dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të punimeve deri në përfundimin e plotë të punimeve.

- Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publik, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo çdoganimit, fotot dhe fatura tatimore përkatëse, ndërsa për mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë e cila duhet të përfshijë objektin përkatës dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të punimeve deri në përfundimin e plotë të punimeve.
- Për fabrikën e asfaltit nëse është në pronësi duhet të paraqiten kontrata e blerjes apo çdoganimit, fotot dhe fatura tatimore përkatëse, leja mjedisore e lëshuar nga QKL. Vendndodhja e fabrikës duhet të jetë në një largësi jo më të madhe se 15 km nga unaza e re e qytetit të Delvines, pasi është menduar që për largësi më të mëdha se kjo, vetitë fiziko mekanike të asfaltit dëmtohen si shkak i uljes së temperaturës së tij.
- Nëse është marrë me qira, krahas dokumentacionit të mësipërm duhet të paraqitet edhe kontrata noteriale e qirasë. Operatori ekonomik për fabrikën e asfaltit mund të paraqesë edhe kontrata të

Dokumenta Standarde të Tenderit

vlefshme furnizimi me operatorë ekonomik. Në këtë rast duhet të paraqes kontratën noteriale të furnizimit dhe dokumentacionin që vërteton ekzistencën e pronësisë së impianteve.

- Për nyjen inerte nëse janë në pronësi duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo çdoganimit, fotot dhe faturat tatimore përkatëse, leja mjedisore e lëshuar nga QKL. Nëse është marrë me qira, krahas dokumentacionit të mësipërm duhet të paraqitet edhe kontrata noteriale e qirasë. Operatori ekonomik mund të paraqes edhe kontrata të vlefshme furnizimi me operatorë ekonomik. Në këtë rast duhet të paraqes kontratën noteriale të furnizimit dhe dokumentacionin që vërteton ekzistencën e pronësisë së impianteve.
- Për mjetet që transportojnë mallra të rrezikshëm duhet të paraqitet certifikata përkatëse e lëshuar nga institucioni kompetent.

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë gjatë fazës së vlerësimit të ofertës e deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas Shtojcës Nr. 10. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese që autorizon AK për të kryer verifikimin dhe kontrollin e deklarimit).

Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruara në procedurat e shpallura fitues me autoritetin kontraktor. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku të deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve në pronësi ose me qira me qëllim verifikimi).

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Shtojca 13

(Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti kontraktor)

PROJEKTI I ZBATIMIT DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE

Përshkrimi i të dhënave teknike të punëve objekt prokurimi të përshkruara sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

KUJDES

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Skicimet, Planimetritë e Objektivit etj:

Specifikimet Teknike të Materialeve:

Grafiku i Punimeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Shtojca 14

PREVENTIVAT E PUNIMEVE

Nr.	Analiza	Emërtimi i Punimeve	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlefte
I. FUSHË VËRRI – KALASË, L = 1601.68 M						
1.		Shtresë stabilizant t=10cm	m ²	9,601.08		
2.		Stabilizant për bankinat t= 6 cm	m ³	96.09		
3.		Shtresë binderi me granil gurrë kave,6 cm, me makineri	m ²	8,008.40		
4.		Spërkatje me emulsion bitumi 1 l/m ²	m ²	8,008.40		
		SHUMA I				
II. BLERIMAS – FINIQ, L = 827 M						
1.		Shtresë stabilizant t= 10 cm	m ²	5,789.00		
2.		Stabilizant për bankinat t= 6 cm	m ³	49.62		
3.		Shtresë binderi me granil gurrë kave,6 cm, me makineri	m ²	4,962.00		
4.		Shtresë asfaltbetoni me granil gurrë kave,4 cm, me makineri	m ²	4,962.00		
		SHUMA II				
		SHUMA I+ II				
		T.V.SH. 20%				
		TOTALI				

Shtojca 15

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

NJOFTIM STANDART PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR⁵

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar Z. /Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 Për Prokurimin Publik.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s'kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi siç parashikohet në Kreun VII të LPP-së.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt
< **Emri** >

⁵ Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore

Shtojca 16

[Shtojcë për t'u plotësuar Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

[Data_____]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____

(me numra dhe fjalë)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____

(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [shuma përkatëse e

Dokumenta Standarde të Tenderit

shprehur në fjalë dhe shifra]/pikët totale të marra [_____]është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit*] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [*vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 17

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. _____
2. _____
3. _____

* * *

Procedura e prokurimit: _____

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia, objekti, kohëzgjatja e kontratës etj]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: oferta ekonomikisht më e favorshme çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatoren e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

2. _____

Dokumenta Standarde të Tenderit

Emri i plotë i shoqërisë _____

numri i NIPT-it _____

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____ / Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____ / Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit], brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 18

KUSHTET E PËRGJITHSHME TË KONTRATËS Punët – Procedura e Hapur

Neni 1: Qëllimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e Punëve të prokuruarra ne bazë të legjislacionit të prokurimit.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e parashikuara në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2: Përkufizime

- 2.1 “Preventiv total” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt te cilat jane orientuese, plotësuar me cmimin total të përcaktuar që është pjesë e Ofertes në një kontratë me çelsa ne dore.
- 2.2 “Preventiv per njesi” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt shoqeruar me cmimet per njesi te pandryshuara që janë pjesë e Ofertes në një kontratë me punime ne matje.
- 2.3 “Afati i realizimit te punimeve” do të thotë data që Punët duhet të perfundojnë siç është shprehur në Grafikon për realizimin Punimeve , e vertetuar nga enti prokurues.
- 2.4 “Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.5 “Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet kontraktorit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.6 “Realizimi i punimeve” do të thotë data e vërtetuar nga Autoriteti Kontraktor se Punët janë mbaruar.

Dokumenta Standarde të Tenderit

- 2.7 “Defekt” do të thotë çdo pjesë e Punimeve e paperfunduar në përputhje me kontratën.
- 2.8 “Data e hyrjes” do të thotë data që Autoriteti Kontraktor lejon kontraktorin në kantier.
- 2.9 “Data e fillimit” është përfshirë në Të dhënat e kontrates. Ajo është data kur kontraktori do të fillojë punimet e ndertimit. Nëse kjo nuk realizohet, “data e fillimit” do të jetë dita në të cilën do të paguhet paradhenia.
- 2.10 “Pajisje” do të thotë makineritë dhe veglat e kontraktorit të sjella përkohësisht në kantier për realizimin e Ndertimeve.
- 2.11 “Materiale” do të thotë të gjitha furnizimet, duke përfshirë ato të konsumit, të përdorura nga kontraktori për kryerjen e punimeve.
- 2.12 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Punët që kontraktori do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.13 “Palë(t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.14 “Drejtues projekti” do të thotë personi i emëruar nga Autoriteti Kontraktor që është përgjegjës për administrimin e kontratës për Autoritetin Kontraktor.
- 2.15 “Autoritet Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe që kontraktori punon objekt i kësaj kontrate. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.16 “Kantier” do të thotë vendi fizik i Punimeve.
- 2.17 “Raport i inspektimit të kantierit” do të thotë dokumentat e përfshira në dokumentat e tenderit që pasqyrojnë informacion faktik dhe të interpretuar rreth kushteve të sipërfaqes dhe nëntokës së kantierit.
- 2.18 “Nënkontraktues” do të thotë çdo person fizik ose ligjor ose kombinim i mësipërm, që furnizon Punët, materialet ose pajisjet për ose në emër të kontraktorit.
- 2.19 “Kontraktor” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate siguron Punimet.
- 2.20 “Standarte Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një trup i posaçëm standartizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarte të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose perkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.
- 2.21 “Ngritja e kantierit” do të thotë punimet e ndertimit të përkohshme, të ndërtuara e instaluar, që janë të nevojshme për zbatimin e punimeve të ndertimit.
- 2.22 “Punime” do të thotë ajo që Autoriteti Kontraktor i kërkon nga kontraktori të gërmojë, ndërtojë, riparojë, rinovojë ose instalojë siç parashikohet në dokumentat e tenderit duke përfshirë shërbimet në lidhje me to, gjithashtu të perkufizuara në dokumentat e tenderit.

Neni 3: Hartimi i Kontratës

- 3.1 Njoftimi i ofertes fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në dokumentat e tenderit.
- 3.2 Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke sanksionuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

Neni 4: Praktikrat e Korrupuara, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t'i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se kontraktori ka kryer veprime të korrupuara. Veprimet e korrupuara përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktori nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ent që ka marrë pjesë në pregatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktori duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t'i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 5: Informacioni Konfidencial

- 5.1 Kontraktori dhe Autoriteti Kontraktues duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktori mund t'i japë nënkontraktorit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar që nënkontraktorin të zbatojë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, kontraktori duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktorin një dispozitë që premtun ruajtjen e konfidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

Neni 6: Prona Intelektuale

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës do t'i përkasin Autoritetit Kontraktor i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, kontraktori, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose pregatitura nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktori mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, po nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.
- 6.3 Kontraktori duhet të garantojë Autoritetin Kontraktor zhveshjen nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale, që mund të dalin nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër sipas kontratës.

- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkëlqje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër të mbrojtur e të furnizuar sipas kontratës, kontraktori duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të kontraktorit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 7: Origjina e Materialeve

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së materialeve, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Kontraktori mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e materialeve.
- 7.3 Për qëllime verifikimi “origjinë” do të thotë vendi ku materialet janë nxjerrë, bashkuar ose prodhuar. materialet janë prodhuar kur, nëpërmjet prodhimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.
- 7.4 Origjina e materialeve ka dallim nga kombësia e kontraktorit ose nënkontraktorit që furnizon me materiale.

Neni 8: Vendimet e Drejtuesit të Projektit

- 8.1 Drejtuesi i projektit do të vendosë për çështjet e kontratës midis kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor
- 8.2 Drejtuesi i Projektit mund të delegojë ndonjë nga detyrat dhe përgjegjësitë e tij tek të tjerët përveç zgjidhjen e mosmarrveshjeve dhe konflikteve. Drejtuesi i projektit duhet të njoftojë kontraktorin për delegimet e bëra apo të revokuara.

Neni 9: Komunikimi

- 9.1 Çdo komunikim midis palëve duhet të bëhet me shkrim.

Neni 10: Bashkëpunimi në Kantier me të Tjerët

- 10.1 Kontraktori duhet të bashkëpunojë dhe të ndajë kantierin me firma të tjera, autoritete publike, shërbimet publike dhe Autoritetin Kontraktor siç kërkohet dhe përkufizohet në Grafikon e realizimit te punimeve.

Neni 11: Përgjegjësia e Autoritetit Kontraktor

- 11.1 Autoriteti Kontraktor ka përgjegjësi të kompensojë kontraktorin për dëmtime të pajisjeve të kontraktorit deri në masën që lidhet me veprime me faj të Autoritetit Kontraktor ose të projekteve të Autoritetit Kontraktor me perjashtim te rastit kur keto te fundit, kishin gabime te dunkshe qe mund te ishin konstatuar lehtesisht nga kontraktuesi.

Neni 12: Raporti i Inspektimit të Kantierit dhe Kushtet e Kantierit

- 12.1 Autoriteti Kontraktor nuk mban asnjë përgjegjësi për konkluzionet ose interpretimet e bëra në raportin e inspektimit të kantierit.
- 12.2 Kontraktori pranon se i ka marrë të gjitha hapat e nevojshme për të verifikuar natyrën dhe vendin e Punimeve dhe se ka inspektuar dhe pajtohet me kushtet e përgjithshme dhe lokale që mund të ndikojnë në kryerjen ose koston e Punëve.

Neni 13: Kontraktori që Kryen Punimet

- 13.1 Kontraktori duhet të kryejë dhe mbarojë Punimet në përputhje me specifikimet teknike të paraqitura në dokumentat e tenderit.
- 13.2 Kontraktori nuk mban përgjegjësi për gabimet në projekt, të dhëna, planimetri ose aspekte të tjera të specifikimeve teknike, të dhëna nga Autoriteti Kontraktor, me përjashtim të rasteve kur gabimi ishte aq i dukshëm sa kontraktori duhet ta kishte vëne re dhe ta kishte reklamuar këtë te Autoriteti Kontraktor.
